

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIA
ZYRA E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA
QENDRA MËSIMORE
440 North Broad Street – 2nd Floor
Philadelphia, Pennsylvania 19130

Njoftim për Rishikimin e Paanshëm për procesin LeGare 2015

Nxënësit e klasave të Teta , me program IEP, Plan 504, ose që marrin mbështetje si Nxënës që Mësojnë Anglisht dhe kanë aplikuar, por që nuk janë pranuar në asnjë prej shkollave të mesme me **Pranim Special, Me pranim nga i Gjithë Qyteti**, ose me **program CTE**, mund të jenë të disponueshëm për një Proçes të Paanshëm dëgjimi LeGare.

Rishikimi i Paanshëm LeGare, është një rishikim i dytë më i fokusuar i Dosjes së Nxënësit (p.sh i rekordeve mësimore, nevojave për mbështetje studimore, etj.) dhe kritereve të pranimit të kërkuara prej shkollave të mesme. Ky rishikim kryhet nga profesionistë të programeve të edukimit special dhe atyre shumëgjuhësh.

Nxënësit e disponueshëm do të marrin një letër duke filluar nga data **15 Maj** me udhëzimet e duhura se si të kërkojnë një Rishikim të Paanshëm LeGare. Në rast se nxënësi merr këtë letër, është përgjegjësi e familjes/kujdestarit, që të bëjë kërkesën. Shkolla nuk mundet të bëjë një kërkesë në emër të nxënësit.

Nxënësit që nuk marrin letër të tillë, nuk janë të vlefshëm për proces Rishikimi: Shëmbujt të mos vlefshmërisë janë:

1. Nxënësit që nuk janë në klasë të 8^{të} dhe shkojnë në klasën e 9^{të}
2. Nxënësit të cilëve u është dhënë pranim provizor/i kushtëzuar
3. Nxënësit emri i të cilëve është hedhur në llotari pranimi, por të cilët nuk janë përzgjedhur nga llotaria
4. Nxënësit të cilët nuk kanë aplikuar për pranim në shkollat me Pranim Special, nga Gjithë Qyteti, ose nga shkollat me kritere pranimi (p.sh program CTE në një shkollë të mesme gjithëpërfshirëse)
5. Prindi i cili ka refuzuar pranimin në një prej shkollave të kërkuara

Një ekip i përbërë nga profesionistë të programeve të edukimit special dhe atyre shumëgjuhësh do të kryej rishikimin e dosjes së nxënësit të cilët kanë kërkuar një Rishikim të Paanshëm.

- Ekipi i rishikimit do të përcaktojë nëse nxënësi, bazuar në kërkesat e IEP, Planit 504, ose programit të tyre të ESOL, mund të jetë i suksesshëm në shkollat e përzgjedhura.
- Ekipi i rishikimit do të marrë vendimin përfundimtar.

Letrat që përcaktojnë statusin përfundimtar do të dërgohen deri në datën **19 Qershor**.

Ju lutemi, për pyetje të tjera kontaktoni si më poshtë:

Për nxënësit me IEP

Dr. Alton Strange
215-400-5666
astrange@philasd.org

Për nxënësit që Mësojnë Anglisht (ELL) ose me diagnozë të Dvfishhtë (IEP & ELL)

Loretta Hulmes
215-400-4240, opsioni #2
lhulmes@philasd.org

Për nxënësit me Plane Shërbimi 15/504

Dr. Naomi Housman
215-400-6872
nghousman@philasd.org

Për pyetje të Përgjithëshme, ose Kërkesë për Rishikim të Paanshëm

Ju mund të dërgoni e-mail: legare@philasd.org